



UNIONI I ARTISTËVE TË FILMIT TË KOSOVËS

STATUTI

NË PRISHTINË
23. Prill. 2012

23 prill 2012

I - DISPOZITAT THEMELORE

Në pajtim me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, ky Statut është baza qeverisëse e shoqatës jofitimprurëse: UNIONI I ARTISTËVE TË FILMIT TË KOSOVËS.

Neni 1- Emri forma dhe adresa

- 1.1. Organizata do të quhet "Unioni i Artistëve të Filmit të Kosovës.
- 1.2. Ai mund të njihet edhe si: UAFK
- 1.3. UAFK është shoqatë joqeveritare sipas definimit të dhënë në ligjin nr. 04/L-57 sipas fletës zyrtare të Republikës së Kosovës të datës 09.09.2011.
- 1.4. UAFK nuk do të bëjë shpërndarjen e çfarëdo fitimi neto ose të profitit të tillë për asnjë individ. Pasuria , të ardhurat dhe profiti i UAFK do të përdoren për të mbështetur qëllimet joprofitabile të UAFK dhe nuk do të përdoren për të krijuar beneficione të veçanta individuale , qoftë në mënyrë të drejtpërdrejt apo indirekte për asnjërin nga themeluesit, kryetarin, nëpunësin, ndonjë anëtar të UAFK, ndonjë të punësuar apo donator të UAFK. Megjithatë pagesa e kompensimit të arsyeshëm për këta persona mund të bëhet për punën që këta persona e kanë bërë për UAFK.
- 1.5. Ndonjë transaksion në mes të anëtarëve , anëtarëve të Kryesinë e UAFK, personi ose nëpunësi dhe UAFK duhet të mbyllet me vlera reale të tregut ose në kushte që janë më të favorshme për UAFK.
- 1.6. Selia e UAFK është në Prishtinë, UAFK e ka vulën e vet në gjuhën shqipe me këtë tekst: Unioni i Artistëve të Filmit të Kosovës-Prishtinë.
- 1.7. Kryesia e UAFK ka të drejtën e ndryshimit të adresës së selisë së UAFK dhe me këtë rast obligohet të informojë anëtarët.

II - THEMELUESIT E UAFK

Neni 2-Themeluesit e UAFK janë:

- 2.1. Isa Qosja, kryetar me vendbanim në Prishtinë, "Dardania" BL. VII -II-21.
Istref Begolli, anëtar, me vendbanim në Prishtinë, "Bregu I Diellit", Rruga II.-

23 prill 2012

L-9-III-10

Agim Sopi, anëtar, me vendbanim në Prishtinë, " Bregu I Diellit" II. BL.
23/22.

- 2.2. Përfaqësues i autorizuar është kryetari i UAFK i cili zgjidhet nga Kuvendi i UAFK dhe përfaqëson UAFK në Kosovë dhe jashtë saj dhe pranon të gjitha shkresat zyrtare në emër të UAFK. Ai/ajo është përgjegjës/e për informimin e autoriteteve relevante administrative për çfarëdo ndryshimi të UAFK.

III - QËLLIMI DHE AKTIVITETI I UAFK

Neni 3 - Qëllimi

- 3.1. UAFK është organizatë profesionale që ka për mision të kontribuoj në zhvillimin e artit kinematografik në Kosovë, si dhe të mbrojë dhe avancoj pozitën e krijuesve të artit kinematografik në Kosovë.
- 3.2. Për realizmin e misioni të vet, UAFK angazhohet për arritjen e qëllimeve në vijim:
 - 3.2.1. Të jetë partner aktiv në procesin e krijimit dhe formimit të të gjitha koncepteve, legjislacionit, modeleve dhe të vendimeve që korrespondojnë dhe ndikojnë në çështjet e artit kinematografik në Kosovë
 - 3.2.2. Të zhvilloj dhe të mbroj interesat e artit të filmit në Kosovë.
 - 3.2.3. Të përfaqësoj strukturën dhe anëtarësinë e vet para institucioneve vendore, qeveritare dhe publike në Kosovë
 - 3.2.4. Të përfaqësoj strukturën dhe anëtarësinë e vet para institucioneve rajonale dhe ndërkombëtare
 - 3.2.5. Të përfaqësoj anëtarët e vet para organizatave, shoqatave dhe dërmarrjeve që kanë marrëdhënie direkt me produksionin, shpërndarjen dhe ekspozimin e produkteve kinematografike.
 - 3.2.6. Sipas mundësive financiare të siguroj konsultime juridike dhe përfaqësim juridik të anëtarëve të vet.

23 prill 2012

IV - ANËTARËSIMI NË UAFK

Neni 4 - Anëtarësimi

- 4.1. Anëtarësimi në UAFK është i hapur për çdo krijues kinematografik që profesionalisht merret me artin e filmit, që është i diplomuar në shkollë superiore përkatëse të licencuar nga Ministria e Arsimit ose që ka diplomë të shkollës superiore përkatëse në ndonjë vend tjetër por të nostrifikuar në Kosovë. Studentët e shkollave superiore përkatëse të licencuar që kanë marrë pjesë profesionalisht në punimin e së paku dy filmave, gjithashtu kanë të drejt të anëtarësohen në UAFK.
Nëse plotësohen kriteret profesionale, anëtarësia në UAFK është e hapur pa marrë parasysh racën , gjininë, orientimin seksual, kombësinë, religjionin, moshën dhe aftësitë fizike.
- 4.2. Kuvendi I anëtarëve (KA) do të vendos me vendim të veçantë nëse do të kërkohet pagesa e anëtarësisë nga anëtarët si dhe lartësinë e pagesës. Mospagesa e anëtarësi, pas paralajmërimit me shkrim, do të shërbej si bazë për përjashtimin e anëtarit nga UAFK.
- 4.3. Anëtarësimi i ndonjë anëtari gjithashtu mund të përfundojë ose suspendohet me vendimin e Kuvendit të Anëtarëve në rast të shkeljes së dispozitave të Statutit, Kodit Etik, si dhe rregullave të tjera të miratuara nga Kuvendi I Anëtarëve të UAFK, e që janë në harmoni me legjislacionin në fuqi në Kosovë dhe standardet dhe praktikën më të mirë ndërkombëtare. Në rast të suspendimit, kohëzgjatja e suspendimit do të përcaktohet nga Kuvendi I Anëtarëve.
- 4.4. Përfundimi ose suspendimi I anëtarësimit bëhet nga Kuvendi I Anëtarëve dhe vendimi I tillë merret nga shumica e votave të anëtarëve prezent.
- 4.5. Anëtarët e UAFK duhet që profesionalisht të merren ose të kenë të kryer shkollën superiore të licencuar, për ndonjërin prej këtyre profesioneve: regjisor, aktorë, drejtor fotografie, skenarist, montazhier, kostumograf, skenograf dhe kompozitor.
- 4.6. Mbështetur në këtë Statut Kuvendi I Anëtarëve do të nxjerrë rregullore rreth procedurave teknike lidhur me anëtarësimin.

23 prill 2012

V - ORGANET QEVERISËSE TË UAFK

Neni 5- Kuvendi i Anëtarëve

- 5.1. Kuvendi i Anëtarëve është organi më i lartë qeverisës i UAFK. Ai përbëhet prej të gjithë anëtarëve të UAFK.
- 5.2. Kuvendi i Anëtarëve ka përgjegjësinë më të lartë për politikën dhe çështjen financiare të UAFK.
- 5.3. Përpos kompetencave që ka Kuvendi i Anëtarëve sipas legjislacionit në fuqi, ai gjithashtu ka edhe këto kompetenca:
 - 5.3.1. Harton dhe miraton rregulloret për punën e kuvendit dhe të kryesisë së UAFK.
 - 5.3.2. Zgjedh kryetarin dhe anëtarët e kryesisë së UAFK.
 - 5.3.3. Përcakton kompetencat dhe detyrat e kryetarit dhe të anëtarëve të kryesisë së UAFK.
 - 5.3.4. Shqyrton dhe miraton të ardhurat, detyrimet, programet, shpenzimet dhe raportet e kryetarit dhe kryesisë së UAFK.
 - 5.3.5. Miraton planet afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata.
 - 5.3.6. Miraton vendimet e kryesisë për hapjen e vendeve të reja të punës.
- 5.4. Kuvendi i Anëtarëve mund të delegoj ndonjë prej përgjegjësve të tij në Kryesinë e UAFK ose ndonjë organ tjetër ose edhe të punësuar të UAFK, me vendimin e shumicës së anëtarëve të tij.

Neni 6 - Mbledhjet e Kuvendit të Anëtarëve.

- 6.1. Kuvendi i Anëtarëve do të takohet së paku një herë në vit në Mbledhjen e Përgjithshme Vjetore /MPV/ ku do të vlerësoje dhe aprovojë mjetet, obligimet, shpenzimet e të hyrave dhe programet për vitet e ardhshme.
- 6.2. Kuvendi i Anëtarëve mund të takohet gjithashtu edhe me Mbledhjen e Përgjithshme të Jashtëzakonshme /MPJ/ kurdoherë që kërkohet nga gjysma e anëtarëve ose nga Kryesia e UAFK. Një kërkesë e tillë duhet të i drejtohet administratorit i cili do të lajmërojë për takimin e të gjithë anëtarët, në pajtim me procedurat të shpjeguara në paragrafin 6.3.

23 prill 2012

- 6.3. Lajmërimi me shkrim për MPV ose MPJ duke përfshirë datën vendin e mbajtjes së mbledhjes, së bashku me rendin e ditës për takimin do të u shpërndahet të gjithë anëtarëve së paku shtatë ditë para ditës së mbajtjes së mbledhjes.
- 6.4. Për mbajtjen e mbledhjes më së paku është e nevojshme pjesëmarrja e 51 përqind të anëtarëve, qoftë me pjesëmarrje fizike apo votë të deleguar. Nëse ky minimum kuorumi nuk arrihet, takimi do të shtyhet për një ditë të caktuar dhe lajmërimi i ri do t'iu dërgohet të gjithë anëtarëve.
- 6.5. Secili anëtarë i UAFK ka një votë në Kuvendin e Anëtarëve.
- 6.6. Vendimet në Kuvendin e Anëtarëve do të merren me shumicën e anëtarëve prezent.
- 6.7. Secili anëtarë i Kuvendit të Anëtarëve mund të abstenojë nga votimi ose marrja e vendimit në çfarëdo çështje për të cilën ata kanë interes personal ose ekonomik.
- 6.8. Çdo anëtarë ka të drejtë të delegimit të votës tek një anëtarë tjetër në rast të pamundësisë së pjesëmarrjes fizike të tij/saj. Delegimi i votës duhet të bëhet me shkrim dhe çdo anëtarë ka të drejtë të ketë maksimalisht dy vota të deleguara. Delegimi është legjitim në bazë të deklaratës me shkrim.
- 6.9. Pjesëmarrja në MPV ose MPJ është obligative për të gjithë anëtarët. Në rast të mospjesëmarrjes së numrit të caktuar sipas nenit 6.4 në mbledhjen e radhës, atëherë mbledhja e Kuvendit të Anëtarëve mbahet me ata pjesëmarrës që janë prezent, dhe vendimet nga ajo mbledhje janë të vlefshme dhe fuqiplota.

Neni 7- Kryesia e UAFK

- 7.1. Përpos kompetencave të dhënave me këtë Statut, Kryesia e UAFK është përgjegjëse për kontrollin dhe udhëheqjen e çështjeve dhe pasurisë së UAFK. Kryesia e UAFK duhet të veprojë çdo herë në pajtim me qëllimet e UAFK.
- 7.2. Përpos kompetencave të dhëna më këtë Statut, Kryesia e UAFK do të ketë gjithashtu edhe këto kompetenca : udhëheqja racionale e mjeteve dhe pasurisë, zbaton konkluzionet dhe vendimet e Kuvendit të Anëtarëve, përgatitë mbledhjet e Kuvendit të Anëtarëve, propozon anëtarët e ri për praninë në UAFK, organizon punën vijuese dhe të ardhshme të UAFK. Përfaqëson UAFK dhe vepron në emër të UAFK, të emëroj dhe zgjedhë përfaqësues, përcakton kompetencat e tyre , të lidhë kontrata e marrëveshje.
- 7.3 Kryesia e UAFK përbëhet nga anëtarët e UAFK. Anëtarët e kryesisë dhe kryetari zgjidhen individualisht nga Kuvendi I Anëtarëve me shumicë votash. Çdo anëtarë i kryesisë do të shërbejë në kohëzgjatje prej Katër (4) vjetësh.

23 prill 2012

- 7.4. Kryesia e UAFK do të ketë të paktën 3 anëtarë.
- 7.5. Anëtarët e Kryesisë së UAFK mund të zgjidhen për 2 mandate të njëpasnjëshme.
- 7.6. Anëtarët e Kryesisë së UAFK mund të shkarkohen para përfundimit të mandatit me vota të MPV -se dhe MPJ-së të Kuvendit të Anëtarëve.
- 7.7. Në raste të vdekjes, dorëheqjes ose shkarkimit të anëtarëve të Kryesisë së UAFK Kuvendi i Anëtarëve duhet të zgjedh pasardhësin për të shërbyer për kohën e mbetur.
- 7.8. Vendimet në Kryesinë e UAFK merren me shumicë.
- 7.9. Kryesia e UAFK mund të vendosë ti drejtohet për çfarëdo çështje Kuvendit të Anëtarëve për marrjen të vendimit.
- 7.10. Kurrfarë pagese ose kompensimi nuk duhet të bëhet anëtarëve të kryesisë pa aprovimin e Kuvendit të Anëtarëve dhe vetëm kur pagesa ose kompensimi është i arsyeshëm dhe bëhet për punën e kryer për UAFK.
- 7.11. Secili anëtar i Kryesisë së UAFK mund të abstenojë prej votimit për marrjen e vendimeve ose për çfarë çështje tjetër për të cilën ata kanë interes personal ose ekonomik.

Neni 8- Kryetari

- 8.1. Kryetari zgjidhet me shumicë të votave nga Kuvendi i Anëtarëve
- 8.2. Procedurat e votimit përcaktohen me rregullore ose vendim të veçantë të anëtarëve
- 8.3. Kryetari përfaqëson UAFK në raport me institucionet kombëtare dhe ndërkombëtare
- 8.4. Kryetari është anëtarë me të drejtë vote në kryesinë e UAFK dhe udhëheq atë.
- 8.5. Në rast të dorëheqjes, mungesës, vdekjes së kryetarit, kryesia e merr përsipër udhëheqjen e UAFK deri në zgjedhjen e kryetarit të ri.
- 8.6 Për detyrat dhe përgjegjësit tjera të UAFK, Kuvendi I Anëtarëve përcakton një rregullore të posaçme

23 prill 2012

VI - SHËRBIMI ADMINISTRATIV I UAFK

Neni 9- Zyrtarët dhe Nëpunësit

- 9.1. Në rast nevojë Kryesia e UAFK do të emërtojë zyrtarë ose të pranojë persona që të marrin përsipër kryerjen e detyrave ditore të UAFK. Kohëzgjatja e punësimit të tyre duhet të caktohet nga Kryesia e UAFK, e cila duhet të informojë Kuvendin e Anëtarëve për emërimet e tilla
- 9.2. Zyrtarët duhet të punësohen përmes marrëveshjes së shkruar e cila i detalizon të gjitha të ardhurat dhe të mirat e tjera që duhet t'i paguhen Zyrtarit. Të gjitha pagesat duhet të jenë të arsyeshme dhe duhet të paguhen vetëm punën e kryer për UAFK.

VII - SHPËRBËRJA E UAFK

Neni 10- Shpërbërja e UAFK

- 10.1. UAFK mund të shpërbëhet me vendimin e shumicës së anëtarëve të Kuvendit të Anëtarëve.
- 10.2 Kur të vendos për shpërbërjen e UAFK, Kuvendi i Anëtarëve do të tregojë emrin e shoqatës ose fondacionit që do të marrë pasurinë e mbetur pasi të jenë liruar nga detyrimet e UAFK. Shoqata, shoqatat ose fondacioni, fondacionet e zgjedhura duhet të kenë qëllime të njëjta ose të ngjashme sikurse UAFK.

VIII - NDRYSHIMET E STATUTIT TË UAFK

Neni 11- Ndryshimet e Statutit

- 11.1. Statuti tanishëm mund të ndryshohet me vendimin e dy të tretave të shumicës së Kuvendit të Anëtarëve.

23 prill 2012

IX - AFARIZMI MATERIAL E FINANCIAR I UAFK

Neni 12 - Periudhat e Raportimit dhe Vitit financiar

- 12.1. Kryesia e UAFK dhe Zyrtarët e emëruar do të paraqesin raporte vjetore para Kuvendit të Anëtarëve, MPV ose kurdoherë që kërkohen nga MPJ.
- 12.2. Viti financiar i UAFK do të përputhet me vitin kalendarik.
- 12.3. Të gjitha çështjet që nuk janë të rregulluara me këtë Statut do të rregullohen me Rregullore dhe akte tjera normative.

X - DISPOZITAT KALIMTARE

- 13.1. Të gjitha çështjet që nuk janë të rregulluar me këtë Statut do të rregullohen me Rregullore të punës dhe akte tjera normative të cilat i aprovon Kuvendi i Anëtarëve në MPV ose MPJ.
- 13.2. Statuti hynë në fuqi në ditën e regjistrimit në regjistrin e OJQ.

Ky Statut i UAFK është aprovuar në Prishtinë, në Kuvendin e Anëtarëve të UAFK më 07.02.2000.

Kryetari

Lirak Çelaj